



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 korrik 2022
Nr.ref.: RK 2024/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI147/21

Parashtrues

Sinan Sinani

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 2/2021, të 12 prillit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sinan Sinani nga fshati Dashec, Komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Arbër Fazliu, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 2/2021, të 12 prillit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 24 shtator 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe me të njëjtin Njoftim kërkoi nga përfaqësuesi juridik i parashtruesit të kërkesës dhe nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojnë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
8. Më 7 tetor 2021, përfaqësuesi juridik i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
9. Më 3 mars 2022, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 17 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, përkatësisht aktgjykimet relevante të gjykatave të rregullta.
11. Më 11 maj 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të shkresave të lëndës dhe kërkesës së parashtruesit, Gjykata vëren se në këtë rast, lidhur me të njëjtën pronë janë iniciuar dy procedura të ndara gjyqësore të cilat janë zhvilluar paralelisht, përkatësisht, procedura penale e zhvilluar kundër A.H. lidhur me shitjen e kundërligjshme të një pjese të ngastrës kontestuese dhe procedura për vërtetimin e pronësisë mbi një pjesë të ngastrës nr. 1037/36, në vendin e quajtur "Fshati Gore", Zona Kadastrale Fushë Kosovë (në tekstin e mëtejme: ngastra kontestuese) dhe se ato kanë specifikat e tyre. Procedura e parë gjyqësore kishte të bënte me procedurën penale kundër A.H. në lidhje me shitjen e kundërligjshme të një pjese të ngastrës kontestuese në të cilën procedurë është nxjerrë Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P. nr. 1147/2006, të 7 korrikut 2006, ndërsa procedura e dytë gjyqësore kishte të bënte me procedurën kontestimore në të cilën parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë të vërtetojë të drejtën e pronësisë së parashtruesit të kërkesës mbi një pjesë të ngastrës kontestuese dhe lidhur me këtë çështje është nxjerrë Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 1182/06 të 20 prillit 2016.
13. Më 16 qershor 2006, Prokuroria Themelore Publike ngriti Aktakuzën PP. nr. 1884-15/2005 kundër A.H., për shkak të dyshimit të bazuar se kishte bërë shitje të kundërligjshme të disa paluajtshmërive, ndër të cilat, edhe të një pjese të ngastrës kontestuese. Më 7 dhjetor 2006, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit P. nr. 1147/2006, e shpalli A.H. fajtor për kryerjen e veprës penale të mashtrimit dhe legalizimit të përmbajtjes së rreme, përkatësisht, për shkak të shitjes së kundërligjshme të disa ngastrave, duke përfshirë edhe ngastrën kontestuese dhe rrjedhimisht i është shqiptuar dënimi me burgim. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore në pjesën që ka të bëjë me shitjen e kundërligjshme të ngastrës kontestuese, theksoi:

"Në raport me të dëmtuarit S. S, S. Q dhe M. B, i akuzuari ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 të KPPK-së për arsye se pasurinë e paluajtshme të cilën fillimisht ia kishte shitur të dëmtuarit S. S, më vonë ua kishte shitur S. Q dhe M. B. I dëmtuari S. S ka mohuar se kishte ndonjë marrëveshje në mes të akzuarit dhe këtij të dëmtuari lidhur me rishitjen e kësaj pasurie të paluajtshme. Edhe ky veprim i të akzuarit paraqet përkushtimin e tij në drejtim të mashtrimit të personave lidhur me shitjen e pasurisë së paluajtshme dhe njëherit nga fakti se ka shitur një pasuri të paluajtshme për të cilën një herë veç i kishte marrë parat nga i dëmtuari S. S, treton se tani i akuzuari mashtrimin e qytetarëve e kishte ushtruar në formë të zejes – përkatësisht si "profesion". [...] Lidhur me kërkesat pasurore-juridike të dëmtuarve gjykata ka vendos që të njëjtit ti udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil sepse këto kërkesa kanë qenë të theksuara në alternativë (ose të kthehet pasuria e paluajtshme, ose të bëhet kompensimi duke konfiskuar pasurinë e paluajtshme të tani të akzuarit e cila mund të jetë e regjistruar në emër të ndonjë personi tjetër (dhe shqyrtimi i këtyre kërkesave do të zvarriste marrjen e vendimit në këtë procedurë penale").

Procedura e zhvilluar sipas kërkesës së parashtruesit për vërtetimin e pronësisë mbi një pjesë të ngastrës kontestuese

14. Më 7 gusht 2001, T.M. dhe A.H. kanë nënshkruar Kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, përkatësisht, të ½ të pjesës ideale të ngastrës kontestuese në sipërfaqe prej 52,92 ari.
15. Më 12 gusht 2001, parashtruesi i kërkesës dhe A.H. kanë nënshkruar Kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, përkatësisht të një pjese të ngastrës kontestuese, në sipërfaqe prej 16 ari, por, në bazë të shkresave të lëndës, me këtë kontratë nuk është specifikuar se cila pjesë e ngastrës është blerë dhe kjo kontratë nuk është vërtetuar në gjykatën kompetente.
16. Më 19 qershor 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti padinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për vërtetimin e pronësisë, me të cilën kërkoi të drejtën e pronësisë mbi një pjesë të ngastrës kontestuese. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës theksoi se tokën prej 16.00 ari, e cila është pjesë e ngastrës kontestuese, e kishte blerë nga shitësi A.H., më 17 gusht 2001, por në vitin 2002, A.H. ua shiti të njëjtën pjesë të ngastrës kontestuese M.B. dhe S.Q., edhe pse obligimi i A.H. ishte t'ia dorëzonte parashtruesit të kërkesës pjesën e blerë të ngastrës kontestuese në mbajtje.
17. Më 20 prill 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit C. nr. 1182/06, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke mos ia njohur parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë mbi pjesën e ngastrës kontestuese.
18. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se parashtruesi i kërkesës,

“nuk e ka bërë të besueshme para gjykatës se është pronar i një pjese të ngastrës lëndore, nuk ka ofruar prova se mbi cilën pjesë të ngastrës është bërë pronar, nuk ka ofruar dimensionet në të cilat pretendon se ka fituar të drejtën pronësore. Gjithashtu, nuk e ka pasur në posedim ose në shfrytëzim pjesën e ngastrës në fjalë. Në një pjesë të ngastrës së përmendur, të paditurit M.B. dhe S.Q. kanë ndërtuar objekte ndërtimore – shtëpi dhe nuk janë penguar nga askush, dhe këtë e kanë bërë mbi bazën e kontratave të shitblerjes të nënshkruara me shitësin, këtu të paditurin A.H. Të paditurit M.B. dhe S.Q., në kuptim të nenit 24 të LMTHJP-së, kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi pjesën e ngastrës lëndore. Paditësi nuk ka dëshmuar para gjykatës se e ka të drejtën e pronësisë mbi pjesën e ngastrës lëndore për të cilën kërkon t'i kthehet. Ai nuk ka ofruar prova për identitetin e pjesës së ngastrës lëndore, përkufizimin e saj, etj. dhe nuk ka ofruar prova se shitësi A.H. ia kishte dorëzuar të njëjtën në posedim. [...]”.

19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit (C. nr. 1182/06) të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 20 prillit 2016, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 29 maj 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ac. nr. 296/17, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e shkallës së parë.

21. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi se:

“[...] paditësi [...] nuk e ka bërë të besueshme para gjykatës se është pronar i pjesës së ngastrës lëndore, pra nuk ka ofruar prova se për cilën pjesë të ngastrës lëndore është bërë pronar, nuk ka ofruar dimensionet në të cilat pretendon se ka fituar të drejtën e pronësisë. Poashtu paditësi asnjëherë nuk e ka pasur në posedim e as në shfrytëzim pjesën e ngastrës së pretenduar. Ndërsa në pjesën e ngastrës së pretenduar të paditurit kanë hyrë në posedim, kanë ndërtuar shtëpitë e tyre, mbi bazën e kontratave të shitblerjes. Sipas nenit 319.1 të LPK-së parashihet se “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta“, e që në rastin konkret paditësi nuk e ka provuar para gjykatës se mbi pjesën e ngastrës lëndore kthimin e së cilës e kërkon, e ka të drejtën e pronësisë, [...] përkufizimin e saj, si dhe nuk ka ofruar prova se iu është dorëzuar ndonjëherë në posedim nga shitësi. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë, e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë rrethanat e këtij rasti rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e Apelit i mori për bazë edhe pretendimet tjera të paditësit, por të cilat nuk ndikuan për të vendosur ndryshe se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 296/17, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

23. Më 12 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. nr. 2/2021 refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

24. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, Gjykata Supreme theksoi se:

“Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet atij që e tjetëron dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Palët nuk e kanë realizuar punën juridike sepse nuk janë shënjuar ngastrat e as sipërfaqja e kontraktuar, nuk është regjistruar e drejta pronësore në regjistrat publik, e që është esenciale për fitimin e pronësisë. Gjykata [Supreme] i pati parasysh mangësitë në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, përkatësisht ku gabimisht konstatohet se të paditurit M.B. dhe S.Q., në kuptim të nenit 24 të LMTHJP, kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi pjesët e ngastrave përkatëse, sepse edhe nëse janë plotësuar kushtet ligjore, kjo duhet të njihet me aktgjykim të gjykatës kompetente, përndryshe ata nuk mund të deklarohen pronarë e as të regjistroheshin pa një proces gjyqësor

konfirmimi, sepse ligjvënësi në nenin 24 i referohet objekteve të ndërtuar në tokën e huaj me mirëbesim. Mirëpo duke marr parasysh se në pyetje është aktgjykimi refuzues, kjo çështje është jo relevante dhe nuk kishte ndikim në marrjen e çfarë do vendimi tjetër sepse aktgjykimet e të dy instancave nuk e vërtetojnë të drejtën pronësore të paditurve në ngastrat konkrete. [...]“.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta, përmes vendimeve të kontestuar, kanë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
26. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon: *“Fillimisht vendimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, e ku përkundër të gjitha provave të cilat kanë dëshmuar të drejtën e pronësisë Gjykata e shkallës së parë ka vendosur për refuzim të padisë e të gjitha këto shkelje nuk janë evituar apo përmirësuar nga gjykatat e më larta të cilat kanë vepruar sipas mjeteve juridike të paditësit”*.
27. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës ankohet në Gjykatë se Gjykata Themelore gjithashtu vërtetoi gabimisht gjendjen faktike, duke pretenduar se: *“Gjykata nuk e ka marrë për bazë fare faktin dhe deklarin e të paditurit të tretë A. H. i cili e ka pranuar në gjykatë se pronën në fjalë ia ka shitur paditësit e për këtë çështje për shkak të mashtrimit i njëjti është shpallur fajtor dhe është dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë sipas Aktgjykimit me P. nr. 1147/2006 (shih në cilësi të proces në shkresat e lëndës aktgjykimin)”*.
28. Parashtruesi i kërkesës më tej gjithashtu pretendon se: *“gjykatat [...] nuk kanë respektuar të drejtat dhe barabarësinë e palëve në procedurë për shkak se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 6 e drejta për proces të rregullt të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive, e ku me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi dhe refuzimin e padisë është cenuar rënd e drejta e pronës e cila garantohet me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*.
29. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, duke pretenduar se: *“Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, nuk janë marrë fare në pretendimet ankimore të paditësit, dhe nuk i kanë marrë për bazë as theksimet nga procesverbalet e seancave të mbajtura, theks në të cilat kishte vënë edhe paditësi në ankesën dhe revizionin e tij. Me këtë përligje të vendimit të shkallës së parë nga Gjykata e shkallës së parë e vazhduar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, paditësi konsideron se po cenohet siguria juridike në Kosovë duke qenë se më askush nuk është i sigurt në blerjen e pronës sepse edhe me pasjen e punës së vlefshme juridike, nuk është e mundur të realizohet e drejta e fituar e as kompensimi adekuat për çmimin e paguar, e të cilin nuk e ka kontestuar askush në procedurë”*.

30. Pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e ndërlidh edhe me zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta. Në këtë drejtim, ai thekson se, *“gjykata është dashur të kujdesej për meritat e padisë dhe mbi bazën e provave të pa kontestueshme t’ia njoh palës paditëse të drejtën e pronësisë apo që minimalisht, me dakordim të palëve relevante të përcaktojë detyrimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar ndaj paditësit”*.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar dhe të kthejë lëndën *“për rishqyrtim dhe rivendosje në shkallën e parë, në Gjykatën Themelore – Departamenti i Përgjithshëm, aty ku ka[në] ndodhur të gjitha shkeljet procedurale ligjore dhe kushtetuese”*.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me lig”.

34. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

- “1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

35. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 përcakton që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. [...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

37. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtgues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu, shih, rastin KI175/20, parashtgues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi

bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri në 284, gjithashtu, shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

39. Në këtë kontekst dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar në rrethanat e këtij rasti, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon dy lloje të shkeljeve, përkatësisht: i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe shkeljet e parimit të sigurisë juridike si dhe ii) shkeljet e pretenduara të nenit 46. Rrjedhimisht, Gjykata do t’i shqyrtojë këto pretendime veç e veç.

i) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike

41. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës konsiston në pretendimin se: *“vendimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, e ku përkundër të gjitha provave të cilat kanë dëshmuar të drejtën e pronësisë Gjykata e shkallës së parë ka vendosur për refuzim të padisë e të gjitha këto shkelje nuk janë evituar apo përmirësuar nga gjykatat e më larta të cilat kanë vepruar sipas mjeteve juridike të paditësit”*.
42. Lidhur me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet se jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë aspekt, dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “Adem Jashari”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

43. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka pohuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo vetë nuk mund të vlerësojë faktet që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56, dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
44. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme arsyetuan në detaje përse nuk e pranuan kërkesën e parashtruesit për vërtetimin e pronësisë mbi një pjesë të ngastrës kontestuese. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç kërkesës për vërtetim të pronësisë, nuk ka paraqitur asnjëherë kërkesë për dëmshpërblim, dhe rrjedhimisht gjykatat e rregullta nuk janë marrë asnjëherë me këtë çështje.
45. Fillimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë [përmes Aktgjykimit C. nr. 1182/06] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit, me arsyetimin se, “[...] *Paditësi nuk ka dëshmuar para gjykatës se e ka të drejtën e pronësisë mbi pjesën e ngastrës lëndore për të cilën kërkon t’i kthehet. Ai nuk ka ofruar prova për identitetin e pjesës së ngastrës lëndore, përkufizimin e saj, etj. dhe nuk ka ofruar prova se shitësi A.H. ia kishte dorëzuar të njëjtën në posedim*”.
46. Më tej, Gjykata e Apelit [përmes Aktgjykimit Ac. nr. 296/17] vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [C. nr. 1182/06] e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se, “[...] *Sipas nenit 319.1 të LPK-së parashihet se “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, e që në rastin konkret paditësi nuk e ka provuar para gjykatës se mbi pjesën e ngastrës lëndore kthimin e së cilës e kërkon, e ka të drejtën e pronësisë, [...] përkufizimin e saj, si dhe nuk ka ofruar prova se iu është dorëzuar ndonjëherë në posedim nga shitësi. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë, e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë rrethanat e këtij rasti rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit [...]”.*
47. Në fund, lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi revizionin e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë.
48. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykimit [Rev. nr. 2/2021] të Gjykatës Supreme, në të cilin arsyetohet se: “*Gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat e LMTHPJ kur e ka konstatuar me të drejtë se në bazë të provave të administruara del qartë se prona nuk është fituar nga paditësi në pajtim me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet pronësore juridike (Gaz. Zyrtare e RSFJ Nr. 6/80) ku parashihet se “E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj” - që nënkupton formën me shkrim, vërtetimin e autoritetit dhe regjistrimin e*

pronës në regjistra publik. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet atij që e tjetëron dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Palët nuk e kanë realizuar punën juridike sepse nuk janë shënjuar ngastrat e as sipërfaqja e kontraktuar, nuk është regjistruar e drejta pronësore në regjistrat publik, e që është esenciale për fitimin e pronësisë“.

49. Gjithashtu, Gjykata i referohet edhe Aktgjykimit [P. nr. 1147/2006] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilin kjo gjykatë vërtetoi fajësinë e A.H., ndërsa parashtuesin e kërkesës dhe palët e tjera të dëmtuara i udhëzoi të iniciojnë kontest civil për realizimin e të drejtave të tyre pronësore. Megjithatë, siç mund të shihet nga aktgjykimet e gjykatave të rregullta, parashtuesi i është drejtuar Gjykatës Themelore me kërkesë për vërtetimin e pronësisë, e cila është refuzuar për arsyet e lartpërmendura.
50. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës ka pasur përfitime nga procedura kontradiktore dhe ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtues *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42, si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, të cituar më lart, paragrafi 58).
51. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtuesi i kërkesës, përtej pretendimeve për interpretimin e gabuar të ligjit, përkatësisht për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si zbatimi i ligjit dhe vërtetimi i gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta, mund të kenë qenë “qartazi të gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtuesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtuesit të kërkesës dhe se të njëjtat i kanë arsyetuar, si dhe kanë arsyetuar qartë përse kërkesa e parashtuesit për vërtetim të pronësisë nuk është e pranueshme (shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
52. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të Kushtetutës për shkak të interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit në fuqi janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtuesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe shkeljet e parimit të sigurisë juridike

53. Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, parashtruesi thekson se *“gjykatat [...] nuk kanë respektuar të drejtat dhe barabarësinë e palëve në procedurë për shkak se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 6 e drejta për proces të rregullt të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive, e ku me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi dhe refuzimin e padisë është cenuar rëndë e drejta e pronës e cila garantohet me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*.
54. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend shkeljet e nenit 46 të Kushtetutës dhe shkeljet e parimit të sigurisë juridike, por në kërkesën e tij nuk ofron më tutje ndonjë arsyetim më të detajuar se si ka ndodhur shkelja e garancive kushtetuese. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81; KI166/20, cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, cituar më lart, paragrafët 38- 39).
55. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe parimit të sigurisë juridike, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

56. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara (i) me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe (ii) me nenin 46 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme në tërësinë e tyre si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 48 të Ligjit, si dhe me paragrafin (1) (d) dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, më 11 maj 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Enesa Caka-Nimani